

Mbikëqyrje e jashtëzakonshme programore ndaj TV Kanal 5 dhe TV Sitel

Shkup, 29.03.2022 – Pas njoftimit të marrë nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, për transmetim të komunikimeve të paligjshme komerciale audiovizuale për suplemente ushqimore është realizuar mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore ndaj TV Sitel dhe TV Kanal 5 .

Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se në kundërshtim me LSHMAAV, në datat 21, 22 dhe 23 shkurt 2022, në programin e TV Kanal 5 dhe TV Sitel, është transmetuar spote me teleshopping për produktet “Bronfo Protekt – 500 ml” dhe “Diabetol Forte – 30 kapsula” të operatorit ushqimor “Natura terapi” SHPKNJP Shkup, në të cilat në mënyrë të rrejshme është paraqitur natyra dhe karakteristikat e tyre, gjegjësisht janë të pavërteta dhe të pandershme, duke çorientuar opinionin dhe në kundërshtim me interesat e konsumatorëve.

Raportet gjenden në linkun e mëposhtme:

TV Kanal 5 (neni 53 paragrafi 5 dhe neni 17 alineja 2 nga LSHMAAV) – 29.03.2022

TV Sitel (neni 53 paragrafi 5 dhe paragrafi 17 alineja 2 nga LSHMAAV) – 29.03.2022